



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-14535 dt. 18/04/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 29.04.2025 (E martë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 28.03.2025;
2. Propozim-vendim për shpalljen e Lordit George Robertson, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit;
3. Propozim-vendim për shpalljen e z. Javier Solana, "Qytetar Nderi", i Komunës së Drenasit;
4. Propozim-vendim për shpalljen e znj. Madeline Albright, "Qytetar Nderi", "Post mortum", e Komunës së Drenasit;
5. Propozim-vendim për plotësim- ndryshimin e Rregullores, Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit;
6. Propozim-vendim për financimin e projektit "Kv Feronikeli femrat"
7. Propozim-vendim për financimin e projektit "Kv Feronikeli meshkujt"
8. Propozim-vendim për financimin e projektit "Fc Feronikeli 74"
9. Propozim-vendim për financimin e projektit "Kh Drenica"
10. Propozim-vendim për financimin e projektit "Kff Feronikeli femrat"
11. Propozim-vendim për financimin e projektit "Klubi Futsalit Drenasi"
12. Propozim-vendim për financimin e projektit "Fc Liqeni"
13. Propozim-vendim për financimin e projektit "Klubi i Boksit Drenasi"
14. Propozim-vendim për financimin e projektit "Kv Gryka"
15. Plani lokal i veprimtimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
16. Raporti financiar janar- mars 2025;
17. Të ndryshme.

Drenas, 18.04.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-14527 dt. 18/04/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 28.03.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj-Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Beqir Kiqina (AAK), Milaim Hajdari (PDK) Muhamet Kurtaj, Qendrim Mulaj.

Munguan: Florentina Elezi-Veliu, Mirlinda Dvorani, Mergim Pirraku.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive.
Mbledhja do të ketë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, dt. 28.02.2025;
2. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, 02 nr.400/03-62198, dt. 28.12.2023;
3. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m²;
4. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m²;

5. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m²;
6. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
7. Raporti vjetor i KRM "Pastrimi" për vitin 2024;
8. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas";
9. Propozim- vendim për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, fjalën e merr Fatmir Baliu.

Fatmir Baliu, tha se duke pasur vështirësitë ekonomike dhe ndikimi i projekteve publike në bizneset lokale, propozojmë që Kuvendi Komunal të shqyrtoj faljen e taksës Komunale për bizneset e Drenasit, arsyetim ndikimi i punimeve në qendër, ndërtimi i sheshit ka kufizuar qasjen në qarkullimin e klientëve dhe ka shkaktuar krizë për bizneset. Ky vendim do të ndihmojë në rritjen dhe rimëkëmbjen e bizneseve në Komunë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nën 1: Nëse e falim taksën duhet me tregu sa është kosto, nën 2: Deri në mars, përmbaruesi na i ka marrë një milion e njëqind mijë euro, nëse ne i falim taksat ne nuk mundemi me bërë asnjë investim në Komunë. Unë mundem me vendos si pikë të rendit të ditës nëse ju e vlerësoni me diskutuar, por kur të rregullohet sheshi vlera e atyre bizneseve rritet. Unë kërkoi me e tërheq këtë pikë të rendit të ditës, sepse është kërkesë e pa kompletuar, e kam menduar me herët unë dhe e kam diskutuar në bord të drejtoreshave.

Mialim Hajdari, unë mendoi që kjo pikë të shtyhet për muajin tjetër me arsyen që Drejtoria për Buxhet dhe Financa, të na e sjell shifrën e saktë të taksave sa paguhet parimisht, jam për me e fal një pjesë të taksave, mirëpo pas një analize të mirëfilltë.

Labinot Halilaj, falja e taksave duhet të këtë arsyetim të fuqishëm, siç ka qenë falja e taksave në pandemi, por ka qenë një situatë e jashtëzakonshme, ne nuk jemi as gjendje lufte as pandemie në qoftë se jemi në investime siç kanë qenë investimet në rrugë të tjera edhe ato biznese kanë pas vështirësi por nuk është falur taksa. Në aspektin human është shumë mirë, por në performancën e investimeve kapitale ndikon shumë keq, në njërin anë bën mirë në tjetrën anë pengon realizimin e projekteve, unë jam dakord me u shty ky propozim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të kisha lutur si koleg mos me i vendos në pozitë të keqe koleget e juaj vetëm pse jemi në vit zgjedhor, ne mund të debatojmë në një pikë të rendit të ditës kur kemi të dhëna për taksa pa të dhëna konkrete nuk mundemi me falë.

Egzona Terdevci, pajtohem plotësisht që nuk duhet të sjellën propozim- vendimet pa një analizë paraprake. Nëse ne si asamblast për çdo seancë nuk e marrim një vendim aty për aty, nuk e besoj që kemi pasur ndonjë seancë që nuk na ka ardhur propozim - vendim sot për sot pa ndonjë analizë paraprake, kështu që është e padrejtë me e bërë këtë argument vetëm kur vijnë propozimet prej asamblesë, e jo kur vijnë prej ekzekutivit, kështu që hidheni në votim nëse votohet mirë, nëse nuk votohet ne e pranojmë rezultatin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se po bëjmë dhjetë minuta pauzë me u konsultuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha vazhdojmë seancën fjala për Fatmirin me e sqaruar edhe një herë cila është kërkesa e tij specifike.

Fatmir Baliu, për ata që kanë dashtë me dëgjuar unë e kam sqaruar, qëndroi mbrapa atij fjalimi se ma ka shkruar dikush nuk di me lexuar edhe një herë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ata që të kanë thënë edhe ata që të kanë shkruar, duhet me ditë se kur të kërkojnë diçka çka po duanë, kryesuesi po të kërkon me e dhënë propozim -vendimin, për faljen e taksës Komunale. Si arsyetim i ke marrë ndërtimet në shesh dhe dëmtimet e bizneseve në shesh, për hir të kolegeve tuaj të të gjitha partive me e bërë propozimin pastaj ne me e regjistruar dhe unë i thërras të gjithë asamblastët propozimin tendë gjatë debatit e shohim se deri ku po arrijmë, a po marrim vendim a ka me qenë i ligjshëm a nuk ka me qenë i ligjshëm dhe ai vendim ka me qenë i mirë për qytetaret e Drenasit, sepse asamblastët janë zgjedhur nga vota e qytetarit.

Fatmir Baliu, propozoi për një pikë shtesë për faljen e taksës komunale për bizneset në Komunën e Drenasit, përveç Feronikelit, gurthyeseve dhe pompave të derivateve kjo është pika që unë jam duke e kërkuar.

Labinot Halilaj, pika e dytë është 2.Draft-propozim për ndryshim-plotësim të Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba 02 nr.400/03-62198, dt. 28.12.2023. Nëse eventualisht ishte dashur me bërë propozime të tilla për faljen e ndonjë takse, unë mendoi që në kuadër të kësaj duhet me qenë në këtë draft-propozim për me u bërë plotësim-ndryshimi nëse eventualisht paska prodhuar ndonjë efekt negativ të ndonjë biznesi në investime kapital unë mendoi që propozimi i Fatmirit ishte dashur me u analizuar edhe pak para se me ardhur në Kuvend.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju thërras me e votuar propozim- vendimin që e propozoi z. Fatmir Baliu për faljen e taksës së operimit me përjashtim të Feronikelit, të gurthyeseve, pompave dhe bankave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë të kërkuar nga asamblasti Fatmir Baliu dhe rendi i ditës kaloi me 26 vota për, kundër 0, abstenim 1.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, më 28.02.2025.
Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rëndit të ditës, kaloi me 25 vota për, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, 02 nr.400/03-62198, dt. 28.12.2023. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e dytë, kaloi me 27 vota për, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me pikën 3: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m².

Egzona Terdevci, parimisht ne si VV, jemi pro dhënies së këtyre pronave me qenë se është edhe në strategjinë e energjisë për dhjetë vitet e ardhshme që me i rritë burimet e ripërtitshme me gjithë atë janë disa gabime procedurale. E para thirrja në propozim-vendim është thirrur në Rregulloren 6/2020, rregullorja që e bënë përcaktimin e dhënies së pronës në shfrytëzim është 9/2020 e kam cekur edhe në seancat e kaluara këtë mundëni me e verifikuar edhe vet.

Te neni 23 i Rregullores 9.2020 përkatësisht paragrafi 5 thotë: Të drejtën e negocimit Kryetari i Komunës mund të shfrytëzojë në rastet kur nuk ka interesim për marrjen e pronës në shfrytëzim nga palët për 3 vjet, me radhë dhe gjatë kësaj kohe nuk ka pasur interesim për marrjen e kësaj pronë në shfrytëzim. Këto prona e dimë që janë kërkuar edhe në dhjetor të vitit 2024 e kam të qartë që është operatori i njëjtë, një pronë që nuk ka miratim paraprak nuk mund të jepet në shfrytëzim ne e dimë që për vitin 2025 nuk e kemi miratuar vendimin paraprak për pronat që jepen në shfrytëzim si dhe duke u thirrur të rregullorja e njëjtë, paragrafi 6 i nenit 23. Këto dokumente që na janë përcjellë nga ekzekutivi mungojnë disa dokumente, plani dinamik dhe vërtetimi i operatorit që nuk ka obligime tatimore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në qofte se ne kemi bërë gabim kërkojmë që kur të bëhet vendimi me u përcaktuar saktësisht Rregullorja 9/2020.

Egzona Terdevci, tha se unë e kam përcjellë këtë vërejtje teknike edhe herën e kaluar, po patjetër që ju mundëni me e verifikuar nëse e kërkon Rregulloren 6/2020, i rregullon kompetencat e Qeveris, kurse 9/2020 është për prona qysh mundet me u dhënë një pronë në shfrytëzim pa një vendim paraprak.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se me një vendim paraprak duhet me ju hap mundësi atyre që duan me aplikuar d.m.th edhe nëse ka operator tjerë me e shqyrtuar këtë mundësi, pra unë kam të drejt me negociuar prona pa qenë të miratuara në listën paraprake, për arsye janë këto me negocim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e tret me ndryshimet që duhet të bëhen në rregullore të cekura nga Egzona Terdevci, kaloi me 26 vota për, kundër 0, abstenim 1.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m². Pasi nuk pati vërejtje, diskutime pika e katërt e rendit të ditës kaloi me 26 vota për, kundër 1, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 5. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën Komunale: P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m².

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me ndryshimet në rregullore të cekura me lartë edhe pika e pestë e rendit të ditës hidhët në votim dhe kaloi me 26 vota për, kundër 1, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023.

Egzona Terdevci, i kam dy pyetje të çështja A3, menaxhimi i kontratave ju përmes E-prokurimit si sfidë e keni vendos mungesën e njohurive, a është ndërmarr ndonjë hap që menaxheret e kontratave të jenë të përgatitur për këtë formë të menaxhimit, pra përmes E-prokurimit edhe për rekomandimin e fundit që ka të bëjë me keq klasifikimin e shpenzimeve, a është bërë padi ndaj nënshkruesve të kontratës e dimë që kanë qënë ish ministrat Lika edhe Ismajli, prej të cilave po buronjë borxhet për fushat e arsimit dhe shëndetësisë për të cilat me të drejt po ankoheni vazhdimisht si dhe duke qënë se Komuna e Drenasit bënë pjesë në asociacionin e komunave. A keni provuar me dërguar në kushtetuese këtë çështje, sepse e dimë që ka përvoja me herët për shembull faljen e tatimit në pronë e keni dërgua.

Vlora Gjinovci kryesuese e Komisionit për Raportin e Auditimit, tha se sa i përket pyetjes për A3 mungesa e njohurive që u theksua është për menaxher të kontratave të ndryshme të cilat munden me qënë edhe drejtor të shkollave dhe zyrtar jo profesional që dinë me e përdorë E-prokurimin, për ndryshe për kontrata kapitale projekte të mëdha E-prokurimi menaxhohet shumë mirë nga menaxherët e kontratave.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të gjithë menaxheret janë duke u trajnuar në nivel qendror për këto çështje nuk jemi vetëm ne. Në këtë rekomandim ne i kemi zbatuar të gjitha rekomandimet, sa i përket kontratave kolektive jam i vetmi që e kam paditur Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Arsimit, po presim epilogun e gjykatës dhe ende nuk na ka thirrur po presim.

Egzona Terdevci, faleminderit shumë për përgjigjen se kam të qartë a janë paditë ata që i kanë nënshkruar kontratat kolektive, duke e shkelur ligjin apo janë paditë vetëm institucionet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë nuk kam të drejtë edhe nuk merrem me individ. Gjykata e pasqyron se kush duhet me u ndjek penalisht, unë nuk paragjykoj kënd duhet me e gjykuar, por mendoj që edhe Ministria përkatëse është dashur vetë me dërguar në Gjykatë që mos me na dëmtuar neve dhe dëmet që na jenë bërë duhet me u kompensuar, ky është edhe qëllimi i jonë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, meqenëse është raport nuk votohet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7. Raporti vjetor i KRM "Pastrimi" për vitin 2024. Fjala për Petrit Reçicën kryeshef i KRM "Pastrimi".

Petrir Reçica, Kryeshef i KRM "Pastrimi", fillimisht i përshendeti të pranishmit, me ç'rast tha se ky report ka të bëjë më shumë me pjesën financiare të njësisë operative të Drenasit nga 1 janari deri në 31 dhjetorin e vitit 2024.

Në vitin 2024 kemi pranuar edhe raportin e auditimit nga Zyra kombëtare e auditimit që ndërmarrjen tonë e kemi kthyer në një raport pozitiv që është i pa modifikuar për dallim nga raportet e kaluara që kanë qene në vlersim të kundërt.

Fillimisht në vitin 2023 nga një bilanc negative ndërmarrja është shtyer në një bilanc pozitiv, ku bilanci për vitin 2024 ka qenë 1 milion e 166 mijë e 100 euro, si një bilanc pozitiv. Në 2024 kemi mbërrir me arritë të hyrat diku për vlerën prej 1 milion e 759 mijë e 602 euro, për dallim të viti të kaluar që kanë qene 9 milion e 32 mijë euro e 974. 14 cent, ndërsa vitin 2024 e kemi përmbyll me bilancin e të hyrave prej 10 milion e 792 mijë e 576 euro.

Gjat vitin 2024 dhe 2025 kemi arritur të kemi të hartuar dhe të përpiluara 14 rregullore të reja, kemi arritur ta ulim numrin e të punësuarve nga 887 punëtorë kemi arritur me zbrit në 825 punëtorë. Kemi arritur që ta përmbyllem edhe me disa investime kapitale, ku gjatë vitit 2024 kemi bërë edhe rritjen e pagave për punëtorët kemi arritur me i rritë pagat dy herë, kemi siguruar shujtën nga 2.5 euro në 5 euro, dhe kemi arritur me e siguruar një kontratë të sigurimit për të gjithë punëtorët.

Komuna e Drenasit është e vetmja komunë ku qytetarët informatat i marrin direkt nga Komuna për dallim nga komunat tjera. Gjithashtu rritja e pagave ka pasur një impakt shumë të madhë financiar në vitin 2023 dhe 2024.

Egzona Terdevci, faleminderit për raportin e detajuar së pari ne si material e kemi pasur vetëm një material në Word, materialet tjera që shkruhet se janë përcjell ne nuk i kemi pasur. Si asamblistë unë i kam dy pyetje, njëra ka të bëjë me terma financiar dhe tjetra me çështje operationale, si asamblist ne marrim në vazhdimësi ankesa për mos marrjen e mbeturinave me kohë e njëjta është përcjellë në vazhdimësi gjatë viteve të

kaluara por ky problem ka qenë edhe në janar të këtij viti.

A ka bërë diçka njësia e juaj që ta rregulloi këtë problem dhe për çështje financiare të vështirësitë që keni pasur në kuptimin e financave si njësi e Drenasit është përmendur edhe pagesa që në një far forme ua ka imponuar Komuna me vendim për dy përfaqësuesit e aksionarit.

A mundem me ditë se sa është pagesa vjetore për këta përfaqësues në "KRM Pastrimi" edhe a janë paguar edhe në mënyrë retroaktive, sepse vendimi i Kuvendit Komunal i janarit 2024 ka qenë i tillë.

Arbër Halilaj, përshëndetje për të gjithë, dua të di prej teje se cilat janë problemet në rajonin e Komunës së Drenasit, specifikisht a ka probleme edhe me inkasim pasi që është kryeshef ekzekutiv e dimë çështjen që e kanë me Komunën e Prishtinës dhe desha të dëgjoj prej jush pavarësisht sukseseve që i ceket që janë për tu përgëzuar, cili është vizioni i juaj për të ardhmen mundësia e thithjes së investimeve bashkëpunimi me OJQ-të, vendorë edhe ndërkombëtar duke marr parasysh edhe kërkesat e agjendës së Gjellbër 2030.

Ku në fakt po u themi mbeturina po ishte mirë edhe emrin me e bërë kompania regionale e mbetjeve, sepse në botën bashkëkohorë konsiderohet si mbetje ose material për riprodhim dhe riciklim cili është vizioni i juaja në këtë aspekt.

Mehdin Salihu, i kam dy tri pyetje nuk e di a keni qenë ndonjë herë në teren, se "KRM Pastrimi", ka mungesë të kamionëve edhe të punëtorëve, pyetja ime është për taksën sa është e lartë ajo nuk diskutohet po pse "KRM Pastrimi", nuk e ka të liruar as një kategori të luftës nga taksa për pastrim.

Petrit Reçica, tha se të pjesa e pagesave të aksionareve, ne për herë të par kemi filluar si menaxhment me i përfunduar obligimet ndaj aksionareve, sepse në të kaluarën një gjë e tillë nuk është bërë deri sot nuk i kemi kryer retroaktive të gjitha obligimet që i kemi ndaj aksionareve për shkak të disa veprimeve më aksionarin kryesor që e kemi në Prishtinë. Kjo na e ka pamundësuar pastaj pjesën e stabilitetit financiar në kuptim të hyrave që i kemi në letra dhe në raporte financiare jemi për herë të parë me bilanc pozitiv me 5% bruto fitim kurse në llogari nuk e kemi një llukës të tillë.

Te pjesa e ankesave ne në Drenas momentalisht operojmë me plan të rregullt operativ me katër kamion aq sa i ka kërkuar plani operativ, gjithashtu kemi arritur me shtuar një kamion të ri për njësinë e Drenasit.

Sa i përket pagesave me klient jo vetëm në Drenas por në të gjitha njësit kemi probleme dhe i vetmi mekanizëm që e kemi për pagesa është përmbarimi privat, mirëpo ne po mundohemi sa më shumë me parandalua këtë formë të pagesës.

Ne kemi vizion të çart dhe kemi adresuar edhe ne planin e biznesit që e kemi si ndërmarrje, qëllimet tona janë të rritet qëndrueshmëria financiare dhe operative e kompanisë të transformojmë kompaninë në një sistem digjital dhe me të arriturat e teknologjisë së avancuar.

Gjithashtu kemi menduar me i rritur kapacitetet humane dhe kapacitetet me makinerinë ne Drenas, sepse është e vetmja Komunë që ndërmarrjen tonë e ka përkrahur me kontrata dhe ne normalisht jemi të interesuar me i rrit shërbimet në kuptim të zbatimit të tyre.

Milaim Hajdari, tha se, inkurajoj që t'i arrini të gjitha këto punë, por ajo që me intereson mua është në bazë të përvojës që kemi hasur këtu ka telashe me mjete pune nga njëherë këtu Drenasi për kundër kësaj punëtorët bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe si përgjegjës dhe i pari i kësaj pune të inkurajojë që të shfrytëzosh autoritetin me donacione për të krijuar të hyra që këta punëtorë të kenë edhe paga të dinitetshme. Edhe një pyetje atje të deponija transit që e kemi të pika transit që është edhe aty nga njëherë ka stermbushje të mbeturinave dhe a keni ne plan për atë pikë me bërë diçka tutje.

Petrit Reçica, tha se sa i përket përmirësimit të kushteve të punëtorëve, ne i kemi bërë do hapa konkret, ju kemi siguruar shujtën, uniformat e reja dhe pajisje mbrojtëse të punës.

I kemi rregulluar të gjitha pajisjet e nevojshme të makinerisë dhe janë duke punuar dhe në vazhdimësi janë duke e bërë zbrazen e pikës të transferit, sidomos për komunat që janë si Drenasi që janë me një pikë me të lartë me deponinë.

Komuna e Drenasit qëndron në nivelin më të mirë sa i përket makinerisë kjo falë punës së Kryetarit dhe juve si Komunë në përgjithësi për shkak që ka arritur me i siguruar masën më të madhe të këtyre pajisjeve përmes grandit të performancës të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se, ne kemi kërkuar një raport për vitin 2024, dhe ky raport është në hartim e sipër, kështu kisha kërkuar që me qenë sa më konkret të raportit, të pika në fjalë.

Egzona Terdevci, kërkoi të dijë se, sa është pagesa vjetore e përfaqësuesve të Drenasit që janë dërguar në "KRM "Pastrimi".

Petrit Reçica, tha se aksionarët e kanë pagën minimale aktualisht 380 euro, e që kjo konsiderohet si honorar e jo pagë e cila është e përcaktuar me ligj.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se, sot e kemi ngritë një pikë tejet të ndieshme dhe fillimisht unë ju vlerësoj për raportin që e keni bërë dua që me e kuptuar të gjithë qytetarët tanë që ne jemi në vit zgjedhorë në Komunën tonë dhe sa herë ka vite zgjedhor në Komunën tonë ka probleme me bartjen e mbeturinave si rezultat i shumë problemeve të ndryshme.

Të gjithë qytetarët ankohen të Kryetari i Komunës, po dua me ju treguar qytetarëve, se Komuna nuk merr vendim dhe nuk i detyron kompanitë siç është kompania e mbeturinave dhe kompania e ujësjellësit, pra janë organizata rajonale dhe ne kërkojmë nga këto organizata që në kryerjen e punëve të jenë sa më të përgjegjshëm.

Ne si Komunë kemi lidhur kontrata me kompaninë "Pastrimi", për shërbime në Komunën tonë. Ju keni ardhur me raportuar para Kuvendit Komunal dhe e vlerësojmë gjithë raportin që e keni bërë.

Egzona Terdevci, tha se, nga kryeshefi u cek se, tarifat duhet me u njësuar për krejt ndërmarrjet krejt njësit, Drenasi e ka 4.7, ndërsa njësitë tjera e kanë 6.20, kështu që po i bien një dallim prej 1.50 cent për faturë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se, sa i përket subvencionimit të qytetarëve, mbetet kjo që të shihet në vitin e ardhshëm.

Petrit Reçica, tha se fatkeqësisht na ka marr kohë shumë kjo pjesa e prishjeve për shkak se këto burokracitë nëpër procedura të prokurimit po janë jashtëzakonisht të larta dhe me afate shumë të gjata. Ne kemi arritur me i rregulluar edhe me një kosto shumë ma të vogël dhe me të shpejtë dhe kjo ka dhënë efektet e veta, normalisht gjithmonë ka hapësirë me punuar shumë e ma shumë por në gjendjen ekzistuese ne po merremi me situata emergjente për shkak të pasojave.

Të pjesa e vlerës totale që e kemi për qytetarët për vitin 2024 me tarifën ekzistuese që e kemi, vlera e faturimit është 411 mijë e 809.20 euro, këtë e kemi kosto vjetore që i faturojmë qytetarët dhe kjo shkon në përputhje me numrin e klientëve. Po ashtu ne jemi duke e planifikuar edhe një komision të veçantë që e bënë regjistrimin e klientëve të ri nëse ka klient ende të pa regjistruar dhe shpejt kemi me përfunduar si proces.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, e falënderoi z. Reçica për raportimin e dhënë dhe përderisa nuk ka ndonjë pyetje rreth kësaj pike, tha se kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës:
Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas".

Egzona Osmanaj-Halilaj, ushtruse e detyres së kryeshefit egzekutiv në ndërmarrjen "Stacioni i Autobuseve", në Drenas, paraqiti Raportin vjetor të vitit 2024, të ndërmarrjes e cila që në fillim ceku se, sfida kryesore e vitit lidhet me gjendjen e vështirë financiare nga themelimi e deri me sot e që nuk kemi gjetur përkrahje që të dilet nga kjo situatë. Për kundër problemeve, bordi i drejtoreve ka pasur angazhime të vazhdueshme në mbikqyrjen e zbatimit të detyrave të përcaktuara me Planin e veprimit të ndërmarrjes dhe realizimin e politikave të përcaktuara me Planin e biznesit për vitin 2024. Sfidë tjetër e kësaj ndërmarrjeje është përcaktimi i kufijve gjeografik ku na kushtezohet për licencimin e ndërmarrjes, vendosja e rrethojës dhe vendosja e një laure për hyrjet daljet në stacion.

Mos nënshkrimi i marrveshjes financiare po na e vështirson gjendjen në ndërmarrje, kështu që kemi bartur shpenzime që nuk kemi mundur me i mbuluar me vlerën 20 mijë euro, pa i llogarit shpenzimet e vitit 2023, që kan qenë prej 50 mijë euro, vlerë totale e këtyre obligimeve të cilat nuk mundë të mbulohen ka arritur në 70 mijë euro.

Të hyrat gjatë vitit 2024 të cilat i kemi vetëm nga peronizimi i autobusave në stacion, por shpenzimet gjatë vitit 2024, ndërmarrja i ka pasur në vlerën prej 52 mijë euro, ku kjo na tregon një bilanc negativ ku kemi humbje afërsisht 20 mijë euro.

Kemi probleme edhe të mbulimi i shpenzimev për paga ku me të hyrat që i kemi nuk mundemi me i mbuluar shpënzimet e pagave, pjesën e operativës, pjesa menaxheriale,

andaj ne kërkojmë që të kemi subvencion nga Komuna e Drenasit, që të mundemi për t'i mbuluar shpenzimet dhe të vazhdojmë të kemi të hyra për mbulimin e shpenzimet kapitale të cilat parashihen për vitin 2025.

Beqir Kiqina, tha se, sa i përket ndermarrjes si shoqëri aksionare NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas", kërkoi të dijë se, a është nënë menaxhimin dhe kompetencat e kësaj shoqërie aksionare menaxhimi i objektit, sepse menaxhimi i objektit dhe tualeteve publike në kuadër të objektit janë rinovuar dhe kam kërkuar edhe në legjislaturen e kaluar edhe tash që me nderhy Kumuna dhe me bërë një investim, në fakt invstimi ka ndodhë por a e mbikëqyrë dikush, sepse ato hapësira janë në një gjendje jashtëzakonishtë të keqe.

Egzona Terdevci, tha se, cila është përgjigja e Komunës së Drenasit, për mos nënshkrimin e marrveshjes për financim, cilat janë pritëshmerit e juaja si ushtruese e detyres së kryshefit, kur mund të bëhet licensimi i plotë.

Po ashtu në këtë raport ceket që i keni 4 punëtorë me kontrata mbi vepër, pse janë angazhuar këta punëtorë, si dhe projektin që e keni realizuar prej Stacionit të Autobuseve në vlerë prej 829, për cilin projektë bëhet fjalë.

Egzona Osmanaj-Halilaj, tha se ne e kemi realizuar një projekt kapital në vlerë prej 829 euro, por nuk është i identifikuar çfar projekt është.

Mehedin Salihu, tha se në këtë dërmarrje kanë qenë tre punëtorë vullnetar dhe kërkoi të dijë se ku kanë mbetur ata punëtor vullnetar.

Egzona Osmanaj-Halilaj, tha se sa i përket menaxhimit të banjove në ambientin e kësaj ndërmarrjeje, ne nuk kemi puntor teknik për mirëmbajtjen e tyre për shkak të buxhetit të ult që e kemi, por pastrimin e tyre e kryejnë punëtorët si dhe pastrimin e hollit dhe zyreve në mënyrë vullnetare.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, falënderoi znj. Halilaj për praqitjen e raportit të saktë dhe korrekt. Sa i përket kufijve gjeografik të "Stacionit të Autobusëve", e dimë që një pjesë hapësinore e këtij objekti ka uzurpime të shumta, dhe ata pronarë që i kan uzurpuar nuk kanë as dokumente ose kanë dokumente false, dhe përderisa nuk kemi përcaktim të kufijve ne nuk mundemi me i vendos rrethojat për këtë objekt.

Po ashtu kam kërkuar nga policia me ju vendosë gjoba autobusëve të Skenderajt nëse nuk i respektojnë rregullat dhe po ashtu ne po mundohemi me fal taksa por nuk po mundemi me i kryer. Gjithashtu e kemi bërë rregullimin e tualeteve, por brenda 24 orëve i kanë shkatërruar.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, duke qenë se mbledhja e Kuvendit Komunal u ndërpre për shkak të mungesës së kuorumit, ju njoftoj se mbledhja do të vazhdojë sot 28.03.2025, prapë në ora 14:30, në Kuvendin Komunal Drenas.


Ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të marrin pjesë, me qëllim që të përmbushim detyrimet tona dhe të shqyrtojmë çështjet e mbetura në rendin e ditës.

Gjatë mbledhjes së sotme të Kuvendit Komunal, nga 11 pika që ishin në rendin e ditës u shqyrtuan vetëm 8 prej tyre, dhe u miratuan katër pika të rendit të ditës me shumicë votash ndërsa për shkak të mungesës së kuoromit mbledhja u ndërpre rreth orës 12:40 minuta, ku e njëjta vazhdoi në ora 14:50 në mungesë kuorumi mbledhja përfundoi, dy pikat e mbetura nuk u votuan por u rekomanduan për mbledhjen e rregullt të radhës.
Si rrjedhojë, për procedurë ligjshmërie do të përcillen vetëm këto katër pika të miratuara në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal.

*Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt.
28.03.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.
<https://youtu.be/dS-uJiuEGdE>.*

Mbledhja përfundoi në ora.15:00

Procesmbajtësja



Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-170/02-13583 dt. 11/04/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më 18.4.2025, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e Lordit George Robertson, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e Lordit George Robertson “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

tulli “Qytetar Nderi” për Lordin George Robertson i jepet për kontributin e tij në përkrahje të Kosovës e popullit të saj në proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

miratimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmërisë së MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Biografi e shkurtër

George Islay MacNeill Robertson, Lordi Robertson u lind në Port Ellen (më 12 Prill 1946) është një politikan britanik që shërbeu si Sekretari i 10-të i Përgjithshëm i NATO-s nga 1999 deri në 2003.

Anëtar i Partisë Laburiste, ai më parë shërbeu si Sekretar Shteti për Mbrojtjen nga 1997 në 1999.

Ai ishte anëtar i Parlamentit (deputet) për Hamilton South (ish Hamilton) nga 1978 deri në 1999 dhe u emërua në Dhomën e Lordëve si koleg i përjetshëm në vitin 2000.

Robertson hyri në Dhomën e Komunave si deputet laburist në 1978, pasi kishte fituar zgjedhjet e pjesshme të Hamiltonit në maj të atij viti. Robertson mbajti zonën elektorale me një shumicë të shtuar dhe mori 51% të votave të përgjithshme. Ai u rizgjodh në Parlament në pesë zgjedhjet e përgjithshme pasuese, ishte Kryetar i Partisë Laburiste në Skoci dhe u emërua në Këshillin Privy.

Në vitin 1999, Robertson u emërua Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s.

Njihet si mik i Kosovës dhe popullit të saj me kontribut të madh për Kosovën, çlirimin dhe shtetndërtimin.

Pas NATO-s, Lordi Robertson ka marrë nderime të shumta (duke përfshirë gjithsej 12 doktorata nderi nga universitete të ndryshme).



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-170/02-13583 dt. 11/04/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më 18.4.2025, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen znj. Madeleine Albright, “Qytetare Nderi”, “Post mortum” e Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e znj. Madeleine Albright “Qytetare Nderi”, “Post mortum” e Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetare Nderi” për znj. Madeleine Albright “Post mortum” i jepet për kontributin e saj në përkrahje të Kosovës dhe popullit të saj në proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-17012-13583 dt. 11/04/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më 18.4.2025, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e z. Javier Solana, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e z. Javier Solana "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Javier Solana i jepet për kontributin e tij në përkrahje të Kosovës dhe popullit të saj nëpër proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Biografi e shkurtër

Havier Solana u lind më 14 Qershor 1942 në Madrid, është politikan me përmasa evropiane nga Spanja.

Pjesë e Partisë Socialiste nga viti 1964, është i diplomuar në Fizikë dhe është një nga diplomatët më të njohur spanjollë. Ka qenë ministër në të gjitha qeveritë spanjolle nga viti 1982 deri në 1995. U emërua sekretar i NATO-s në vitin 1995 deri në 1999, ku pati angazhim të drejtpërdrejtë me luftën e Kosovës.

Z. Solana gjatë bombardimeve të caqeve ushtarake serbe, dëshmoi konsistencë dhe qëndrueshmëri në misionin dhe vizionin e NATO-s për lirinë e Kosovës.

Nga viti 1999 deri në 2009 ka qenë përfaqësues i lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë e Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të Kosovës i është drejtuar popullit të Kosovës me një mesazh.

Në mesazhin e tij, Solana thotë “se e mban në zemër popullin e Kosovës”.

Ai tha se Kosova duhet të shndërrohet në një shtet të fortë.

“Duhet të jeni të aftë për të ruajtur demokracinë, të aftë ta ruani lirinë dhe të gatshëm të përgatiteni për ndryshimin e madh, që do të jetë integrimi evropian”, tha ai në mesazhin e tij për popullin e Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr - 030/01 - 10446 dt. 19/03/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit nr. 2004/18 për Tegetin e Brendshme, Ligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, propozon:, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.07.2023 të aprovoj:

PROPOZIM VENDIM

Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Bizneseve në Komunën e Drenasit

NENI 1

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

NENI 3

- **Ndryshohet Neni 15 – Pika - 15.1.**

Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private (e hëne - e shtune)

15.1.1 Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonat dhe fillon prej orës 08:00, ndërsa mbaron në orën 22:00.

15.1.2 Orari i punës për barnaret kujdestare në Komoran dhe Drenas do të jetë:

Në sezonin veror 08:00 deri 20:00 ndërsa;

Në sezonin dimëror 08:00 deri 19:00.

(Përfundimisht të shtunave orari i rregullt do të jetë nga ora 08:00 deri në ora 14:00)

- **Ndryshohet Neni – Pika - 15.2.**

16 Në rast të nevojave emergjente mund të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt (të dielave dhe gjatë festave shtetërore) sipas paragrafit 15.1.1. me një akte të veçantë.

- **Ndryshohet Neni – Pika - 15.3.**

Barnatoret që veprojnë në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran do të kujdestarojnë:

Në sezonin veror nga ora 20:00 deri në 08:00 ndërsa

Në sezonin dimëror nga 19:00 deri në 08:00;

Ndërsa të shtunave orari i kujdestarisë do të filloj nga ora 14:00 deri në ora 08:00 njëjtë në të dy sezonet, si dhe dielave e festave zyrtare do të kujdestarohet 24 orë pa ndërprerë.

Shtohet : Neni – Pika - 15.4.

Orari i kujdestarive do të përpilohet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik sipas listës së caktuar për barnatoret në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran të caktuar nga Drejtoria e Inspektionit çdo fund vit dhe në rast të ndryshimeve aktuale.

NENI 3

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Gjatë zbatimit në praktik të Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019 ndjehet e nevojshme të bëhet plotësim/ndryshimi i nenit 15 të rregullores. Bazuar në kërkesat e kohëpaskohshme të bizneseve konkretisht barnatoreve të cilat operojnë në qendër në Drenas dhe barnatoreve në qendër në Komoran lidhur me përpilimin e orarit të kujdestarive të barnatoreve, kërkohet nga ana e kryetarit të Komunës që të bëjë Plotësim ndryshimi e Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

Me respekt.

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		11/09/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	030/d-	135	89



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government



Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit si dhe bazuar në Ligjin nr. 08/l-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore në familje, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2025 të aprovoi këtë:

PROPOZIM/VENDIM

**Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe
 dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave
 Drenas (Gllogoc)
 2025 – 2027**

Neni 1

Me këtë propozim vendim Zyra e Kryetarit -Njesiti për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjimore me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, synon plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, në bazë të së cilit edhe është hartuar Ligji nr. 08/l-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore në familje, që dhunën në familje e përkufizon si veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezultojnë me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie me familje. Sipas këtij ligji dhuna ndaj grave kuptohet si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjimore që rezultojnë në ose ka të ngjarë të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik apo vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij plani janë përgjegjëse Zyra e Kryetarit- Njesiti për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjimore si dhe organet kompetente në kuadër të Komunës së Drenasit.

[Signature]

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji nr. 08/l-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore në familje, që dhunen në familje e përkufizon si veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezultojnë me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie me familjen”. Sipas këtij ligji dhuna ndaj grave kuptohet si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimi ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë në ose ka të ngjarë të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik apo vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjimore (2022-2026) që njëherazi paraqet një vazhdimsi logjike të përkushtimit të institucioneve Qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal, në vazhdimësi të planeve të hartuara në Komunë, u hartua ky plan zbutës përmes hapave që përfaqësues të institucioneve të linjës konsiderojnë si ndihmues apo mbështetës.

Ky plan kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje.

Plani lokal i veprimit kundër Dhunës në ndaj Grave dhe Vajzave (DHGV) për Komunën e Drenasit, synon të:

1. Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
2. Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
3. Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
